Nr 4 prot dt 24.02.20

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË**

**VENDIM**

Nr. 3, datë 20.02.2025

**PËR**

**MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR PËR QËLLIME INDUSTRIALE, TË SUBJEKTIT "FLOROS" SH.P.K., ME VENDNDODHJE: LAGJIA SHIMAJ, NJËSIA ADMINISTRATIVE BUSHAT, BASHKIA VAU I DEJËS, QARKU SHKODËR.**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, "Për Burimet Ujore", dhe Vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "*Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre*", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime industriale, të subjektit "Floros" sh.p.k., me vendndodhje: Lagjia Shimaj, Njësia Administrative Bushat, Bashkia Vau i Dejës, Qarku Shkodër.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Akuiferi që kërkohet të shfrytëzohet: Trupi ujor i shpimit nr. 1/2010 (Bushat)

Koordinatat e vendndodhjes së shpimit (KRGJSH)

**Pus Shpimi nr. 1/2010 (Bushat)**

X=462147; Y=4648425; Z=12.7 m.m.n.d

Koordinatat e vendndodhjes së pikës ku do të shfrytëzohet uji (KRGJSH)

X=462124; Y=4648396; Z=12.4 m.m.n.d

Qëllimi i përdorimit të ujit: Për qëllime industriale (ftohje e sharrave të mermerit)

Prurja e ujit të kërkuar: Q = 2.6 l/sek

Prurja mesatare vjetore: $Q_{mes\text{-}vjet}$ = 4 l/sek

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH)

X=462069; Y=4648396; Z=12.2 m.m.n.d

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektit.

**KRYETARI I KBU DRIN-BUNË**

**MAJLINDA ANGONI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË